



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISTINA

Rr. "George Bush", Ndërtesa e Rektoratit, Nr. 31, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 1/152
Data: 16 / 4 / 2026

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, në bazë të kompetencave të përcaktuara me nenin 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.12, dhe në zbatim të neneve 39 dhe 45 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, si dhe në bazë të nenit 5, pika 5, të Rregullores për parimet e punës dhe funksionimin e instituteve dhe qendrave në Universitetin e Prishtinës, me nr. prot. 1/953, të datës 21.08.2025, në pajtim me dispozitat e nenit 19, nenit 28, pika 1, nënpika 1.1, të Rregullores së punës nr. 280, të datës 13.2.2025, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja për parimet e punës dhe funksionimin e Institutit për Struktura, Materialet dhe Gjeomekanikën.
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Rregullorja për parimet e punës dhe funksionimin e Institutit për Struktura, Materialet dhe Gjeomekanikën në Universitetin e Prishtinës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.04.2026, ka shqyrtuar dhe miratuar Rregulloren për parimet e punës dhe funksionimin e Institutit për Struktura, Materialet dhe Gjeomekanikën. Qëllimi i saj është të rregullojë parimet e punës dhe funksionimin e këtij institutit, përmes të cilave synon krijimin e kushteve për kontribut në këtë fushë, të mundësojë zhvillimin e hulumtimeve shkencore me rëndësi strategjike për struktura, materialet dhe gjeomekanikën, universitetin dhe shoqërinë, duke nxitur kërkimet ndërdisiplinore, të avancojë infrastrukturën për realizimin e projekteve hulumtuese-shkencore, për të ofruar shërbime efikase në fushën e strukturave, materialeve dhe gjeomekanikën, të rrisë bashkëpunimin shkencor dhe profesional me institucione hulumtuese, vendore e ndërkombëtare, brenda e jashtë Kosovës, të promovojë vlerat e saj si në shkencë, dije e profesione të tjera. Nga ajo që u tha më lart dhe mbi këtë bazë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Zyrës Ligjore të UP-së;
3. Institutit për Struktura, Materialet dhe Gjeomekanikën;
4. Asistentit të KD-së.

